



Periodiku AMF

Bordi i AMF-së, miraton rregulloren “Për primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”

Në mbledhjen e datës 28 gusht 2009, Bordi i AMF-së, ndër të tjera, miratoi Rregulloren “Për primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, hartuar në mbështetje të nenit 10, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe pikës 3, të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. Në hartimin e kësaj rregulloreje, janë marrë në konsideratë veçoritë e produkteve të ndryshme të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, si dhe përvoja e deritanishme e kushtet aktuale të zhvillimit të tyre.

Vijon në faqen 2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar-korrik 2009

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-korrik, arritën shifrën 4,774,485 mijë lekë, përkundrejt 4,027,102 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2008 ose 18.56% më shumë.

Vijon në faqen 2

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Kriza Financiare Globale - Po më pas? (Material i shkëputur nga faqja zyrtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Aktuarëve (IAA))

Prezantim

Shkaqet dhe ndikimet aktuale të Krizës Financiare Globale (KFG) tashmë janë

qartësisht të njohura dhe të analizuara nga një seri studimesh dhe komentuesish anembanë botës. Ajo çka është e qartë, është fakti që ne jemi duke jetuar një moment, i cili mund të ndodh vetëm një herë në karrierën e punës së një personi të veçantë, efektet e saj do të jenë depërtuese në disa aktivitete në interes të aktuarëve dhe ja vlen të mendosh atë që çfarë ne duhet të parashikojmë se do të shfaqet akoma në të ardhmen duke u nisur nga fakti që ndikimet e KFG aktualisht po vazhdojnë të ndodhin, veçanërisht lidhur me reformën rregullatore.

Vijon në faqen 5

Edukimi i konsumatorit

IFRS dhe Solvency II: Ekspozimi dhe bashkëveprimi Global – Puna e IAIS.

(Pjesë e shkëputur nga: The Geneva Papers on Risk and Insurance Issues and practice, Vëllimi 33, nr. 1, janar 2009)

Parathënie

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS) është një organizatë ndërkombëtare, e cila përbëhet nga mbikëqyrës në sigurime nga 180 autoritete të 130 vendeve, që mbikëqyrin siguruesit të cilët përbëjnë përafërsisht 97% të tregjeve botërore të sigurimeve. Një nga objektivat e saj kryesore është të ndihmojë në zhvillimin e tregjeve të mirërregulluar të sigurimeve. Duke qenë se kjo kërkon një cilësi të lartë të raportimit financiar, IAIS është shumë i interesuar në zhvillimin e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar.

Vijon në faqen 12

Në këtë numër:

Bordi i AMF-së, miraton rregulloren “Për primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit” **2**

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura **2**

Ngjarje dhe zhvillime të tjera **5**

Edukimi i konsumatorit **12**



Bordi i AMF-së, miraton rregulloren “Për primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”

Në mbledhjen e datës 28 gusht 2009, Bordi i AMF-së, ndër të tjera, miratoi Rregulloren “Për primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, hartuar në mbështetje të nenit 10, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe pikës 3, të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. Në hartimin e kësaj rregulloreje, janë marrë në konsideratë veçoritë e produkteve të ndryshme të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, si dhe përvoja e deritanishme e kushtet aktuale të zhvillimit të tyre.

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i nivelit të primeve dhe provigjoneve teknike, përmbajtjes së bazës teknike të të dhënave, metodikave për përlogaritjen e primeve dhe provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit dhe përcaktimi i procedurave e afateve, për miratimin nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të tabelave të primeve të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.

Autoriteti, nëpërmjet kësaj rregulloreje, ka vlerësuar rëndësinë e përcaktimit të primit të rrezikut nga komiteti i aktuarëve. Në mungesë të një baze të plotë të të dhënave, aktuari i çdo shoqërie e ka të vështirë të bëjë supozimet dhe vlerësimet e duhura në përcaktimin e primit të rrezikut. Kjo situatë shmanget nëpërmjet përfshirjes në këtë proces të komitetit të aktuarëve.

Rregullorja përmban kërkesa të ngjashme me ato ekzistueset për sigurimet e detyrueshme të përgjegjësive motorike, parashikon kriteret statistikore, aktuariale dhe përvojën e risiguruesve në përcaktimin e sistemit tarifor të çdo shoqërie për produkte të tjera, përveç atyre të sigurimit të përgjegjësive motorike, si dhe mbështet metodikën e llogaritjes së provigjoneve teknike, sipas rregullores “Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimit të jo-jetës” të miratuar nga Autoriteti.

Gjithashtu, në këtë rregullore janë përcaktuar hapat në përlogaritjen e tarifave të primeve dhe provigjoneve teknike, si edhe afatet e depozitimit dhe të miratimit të tabelave të primit të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.

Plotësimi i bazës së të dhënave të dëmeve me të dhënat historike dhe tendencat që do të vërehen nga zbatimi i Ligjit të ri nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, do të përbëjnë bazën për të kaluar në modelin e tarifimit të primit nga çdo shoqëri, në një fazë të dytë.

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar-korrik 2009

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-korrik, arritën shifrën 4,774,485 mijë lekë, përkundrejt 4,027,102 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2008 ose 18.56% më shumë.

Vihet re një ndryshim i strukturës së tregut të sigurimeve. Primet e shkruara bruto të sigurimit


vullnetar zunë 47.34% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 52.66% të tregut, ku në krahasim me vitet e mëparshme primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zinin pjesën më të konsiderueshme të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, kemi një rritje në masën 35.17% të sigurimeve të Jetës dhe 17.2% të sigurimeve të Jo-Jetës.

Megjithë rritjen që shënuan sigurimet e Jetës,

sërisht 91.38% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës.


Gjatë 7-mujorit të parë të 2009 u nënshkruan rreth 444,574 kontrata sigurimi me një rritje prej 23.74%, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2008.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar - korrik 2009



Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto, janar - korrik (2008 - 2009)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
Periudha janar-korrik	2008	2009
A) Sigurimi i Jetës	304,433	411,503
B) Sigurimi i Jo - Jetës	3,722,669	4,362,982
Nga këto		
a) Sigurimi i Detyrueshëm	2,305,037	2,514,309
b) Sigurimi Vullnetar	1,417,632	1,848,674
TOTAL	4,027,102	4,774,485



Sigurimet e detyrueshme

Gjatë periudhës janar-korrik 2009, sigurimet e detyrueshme motorike vazhduan të dominojnë strukturën e tregut, duke sjellë 52.66% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme, në 7-mujorin e parë 2009, arritën 1,661,077 mijë lekë, ose 2.85% më shumë se në periudhën janar-korrik 2008.

Në janar-qershor 2009, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 684,355 mijë lekë, ose rreth 24.4% më shumë se në periudhën janar-korrik 2008.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë 7-mujorit të parë të 2009 arritën në 168,877 mijë lekë, apo 20.82% më shumë se në periudhën janar-korrik 2008.

Sigurimet vullnetare

Në periudhën janar-korrik 2009, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 2,260,177 mijë

lekë, ose 31.25% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 1,848,674 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 29.06%, të pasuara nga sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me 21.95% dhe sigurimi kasko me 19.86%. Peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, si dhe sigurimet e garancisë.


Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit në janar-korrik 2009 arritën në 252,122 mijë lekë, ose 49.38% më shumë se në periudhën janar-korrik 2008. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 77.44% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e jetës në 7-mujorin e parë të vitit 2009 arritën në rreth 411,503 mijë lekë, ose rreth 35.17% më të larta se në po të njëjtën periudhë të vitin 2008. Rritja në sigurimet e Jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredithënies dhe sigurimit të Jetës për efekt kredie.


Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interbalkanian, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 29.23% të primeve.

Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, janar-korrik 2009 (Jo-Jeta)



Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, janar-korrik 2009 (Jeta)



Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan shoqëritë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me 55.36 % të primeve.

Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar-korrik 2009 kapi vlerën 926,231 mijë lekë, ose 27.4% më shumë se në janar-korrik të vitit 2008. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimeve motorike me 821,021 mijë lekë, apo 88.64% të totalit. Në portofolin “Kartoni Jeshil” kemi një rritje të dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimit me 37.4% dhe rritje të numrit të dëmeve të paguara me 25.93% krahasuar me periudhën janar-korrik të vitit 2008.

Risigurime

Gjatë periudhës janar-korrik 2009, primet nga aktiviteti risigurues kapën vlerën 11,403 mijë lekë,

të cilat i përkasin sigurimit “Aksidente Personale” dhe “Kasko”.

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Kriza Financiare Globale - Po më pas?

(Material i shkëputur nga faqja zyrtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Aktuarëve (IAA))

Prezantim

Shkaqet dhe ndikimet aktuale të Krizës Financiare Globale (KFG) tashmë janë qartësisht të njohura dhe të analizuar nga një seri studimesh dhe komentuesish anembanë botës. Ajo çka është e qartë, është fakti që ne jemi duke jetuar një moment, i cili mund të ndodh vetëm një herë në karrierën e punës së një personi të veçantë, efektet e saj do të jenë depërtuese në disa aktivitete në interes të aktuarëve dhe ja vlen të mendosh atë që çfarë ne duhet të

parashikojmë se do të shfaqet akoma në të ardhmen duke u nisur nga fakti që ndikimet e KFG aktualisht po vazhdojnë të ndodhin, veçanërisht lidhur me reformën rregullatore.

Sipas Lord Turner, Kryetar i Autoritetit të Shërbimeve Financiare UK:

Kriza Financiare ka sfiduar supozimet intelektuale mbi të cilat ishin ndërtuar gjerësisht metodat e mëparshme rregullative dhe në veçanti teorinë e tregjeve racionalë dhe vetërregullues. Risia e madhe financiare rezultoi me një vlerë të ulët dhe disiplina e tregut të strategjive të bankave individuale shpesh ka rezultuar joefektive ... janë të nevojshme ndryshime të mëdha në metodën rregullative dhe mbikëqyrëse.

Tabela (më poshtë) paraqet shtrirjen e ndikimit të KFG deri më sot në vlerën e tregut si të bankave dhe siguruesve në nivel ndërkombëtar.

Ndërlikime për shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensioneve

Në momentin e këtij shkrimi është e qartë që KFG akoma nuk ka përfunduar dhe mund të priten akoma zhvillime të mëtejshme. Në veçanti, siguruesit si dhe sponsorët, si nga sektori privat dhe ai publik i skemave të pensioneve, me përfitim të përcaktuar ose të pensioneve të pleqërisë dhe aktuarët e tyre, mund të presin:

- Norma të ulëta aktuale të interesit të tregut, të cilat do të çojnë në norma të ulëta skontimi, të zbatuara tek detyrimet dhe kështu në vlera më të larta të detyrimeve.
- Vlera të ulëta të asetëve, veçanërisht në juridiksione ku asetet vlerësohen me vlerë të tregut, të cilat (me vlera më të larta të detyrimeve) do të çojnë në presion

të konsiderueshëm mbi të ardhurat e siguruara, kapitalin dhe aftësinë paguese.

- Vështirësi të konsiderueshme dhe të vazhdueshme në vlerësimin e asetëve jo-likuide.
- Sfida të mëtejshme duke përdorur të dhëna nga tregu për të ndarë masat e dhënies së kreditit nga marzhet e likuiditetit, me qëllim që të arrihen norma të përshtatshme të skontimit për detyrimet.
- Rivlerësim i disa parametrave në modelet e Analizave Financiare Dinamike dhe/ose “modelet e brendshme” të përdorura për të vlerësuar kërkesat ekonomike për kapital.
- Domsdosshmëria për të rishikuar metodologjinë dhe supozimet e përdorura për llogaritjen e përfitimeve nga diversifikimi në portofole dhe/ose nivelin e shtrirjes së korrelacionit ndërmjet risqeve në tregje dhe hapësirave gjeografike të ndryshme të produktit.

Siguruesit mund të presin gjithashtu efektet e mëposhtme të cilat përfshijnë:

- Siguruesit e jetës me garanci të konsiderueshme kapitali ose obligacione kreditimi me një normë interesi minimale që ekzistojnë në detyrimet e tyre të produktit do të jenë nën një presion të madh nëse pozicionet e tyre janë të pa mbrojtura.
- Vlerat e përbëra (eng. “embedded values” që do të thotë vlera aktuale e fitimeve të ardhshme plus vlerën neto të rregulluar të asetëve) e raportuara nga siguruesit kanë të ngjarë të bien.
- Normat e reduktuara të kreditimit do të çojnë në uljen e bizneseve të reja.

Kërkesa potenciale e likuiditetit mund të rrisë anulimet: (eng. surrender)

- Kërkesa të reja të mundshme, të cilat

ndikojnë në pranueshmërinë e shtresës së dytë ose kapitalit hibrid, të cilat çojnë në një nevojë potenciale për të rritur në nivele të konsiderueshme shtresën e parë të kapitalit.

- Kthime të ulëta nga investimet, të cilat rrisin normat e primeve të kërkuara për biznesin e anuitive dhe për klasat e biznesit të jo-jetës afatgjata.
- Ndryshimi i metodës së kostove të dëmeve të jo-jetës e shoqëruar me kushte ekonomike të këqija p.sh., sigurimi hipotekor i huadhënësit, përgjegjësitë profesionale, drejtorët dhe nëpunësit, klasat e kompensimit të dëmtimit trupor dhe të punonjësve mund të shfaqin ndryshime në eksperiencë.
- Një rritje e fokusimit në përshtatshmërinë e klasifikimit të kreditit të palëve të tjera, duke përfshirë risiguruesit.

Në një pikëpamje më të gjerë është gjithashtu e qartë që kuadri rregullativ për të gjitha institucionet e shërbimeve financiare ka të ngjarë të rishikohet tërësisht në një përpjekje për të parandaluar një përsëritje të KFG në të ardhmen. Për të gjithë anëtarët me profesion aktuarë do të jetë e nevojshme të jenë në dijeni të këtyre ngjarjeve dhe të jenë të përgatitur për proceset e rimëkëmbjes dhe të reformës rregullatore, të cilat padyshim do të zhvillohen.

Në veçanti, takimi më i fundit i G20, i mbajtur në Londër, në 2 prill 2009, i kryer sipas një axhende të përcaktuar, kishte për qëllim:

- Rikthimin e besimit, rritjen ekonomike dhe të vendeve të punës nëpërmjet një zgjerimi fiskal të përbashkët;
- Rregullimin e sistemit financiar për të rikthyer huadhënien, duke përfshirë një bashkëpunim më të madh sistematik ndërmjet rregullatorëve kombëtarë dhe krijimi i Bordit për Stabilitet Financiar, të zëvendësojë Forumin për Stabilitet

Financiar, në mënyrë që të përmirësohen mekanizmat ndërkombëtarë të paralajmërimit të hershëm të riskut;

- Forcimin e kuadrit rregullator financiar për të rikthyer besimin duke e shtrirë mbikëqyrjen tek të gjitha institucionet sistemike të rëndësishme, duke përfshirë dhe fondet “hedge” dhe agjencitë e klasifikimit të kreditit;
- Miratimin e parimeve të reja, të cilat mbulojnë shpërblimet e bazuara në stimuj për drejtuesit ekzekutivë;
- Futjen e sanksioneve kundrejt “parajsave të taksave” (eng. tax havens) dhe ndryshime të konceptuara për t’i dhënë fund “erës së fshehtësisë bankare”;
- Themelimi dhe reformimi i institucioneve kryesore financiare ndërkombëtare, duke përfshirë një trefishim të burimeve të disponueshme të Fondit Monetar Ndërkombëtar;
- Nxitja e tregtisë dhe investimeve dhe refuzimi i proteksionizmit;
- Ndërtimi i një rimëkëmbjeje gjithëpërfshirëse, të dukshme dhe të qëndrueshme, adresimi i kërcënimeve të ndryshimit të klimës.

Zhvillimet e reja më të fundit me interes për aktuarët

Shoqata Ndërkombëtare Aktuariale (SHNA) ka qenë aktive në adresimin e këtyre çështjeve gjatë muajve të fundit, nëpërmjet punës së një taskforce të formuar për këtë qëllim, e cila është fokusuar në identifikimin e mësimave të nxjerra nga kriza dhe të sugjerojë reforma potenciale, përmirësime dhe zgjidhje, shumica e të cilave do të ndikojnë në punën e aktuarëve.

Detaje mbi disa punime të SHNA-së në këtë fushë janë paraqitur në studimin [Të Luftosh Iracionalitetin-Idetë aktuariale për Forcimin e Manaxhimin e Riskut Financiar Global](#) (Studim i SHNA në shkurt) i cili mund të shkarkohet nga



faqja elektronike e SHNA-së (www.actuaries.org).

Gjatë javëve të fundit prezantimet dhe riprezantimet mbi këto çështje janë bërë nën përfaqësimin e profesionit të aktuarit tek:

- a) Rregullatorët e ndryshëm kombëtarë të bankave, siguruesve dhe фондеве të pensioneve;
- b) Shoqata Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime;
- c) Forumi i Përbashkët (një grup ndërkombëtar i rregullatorëve bankarë, sigurimeve dhe tregjeve të letrave me vlerë);
- d) Konferenca e mbajtur në Qipro “Pensionet në Krizë”, mbi Sigurimet Sociale, Pensionet dhe Fondet e Kursimit;
- e) Bordi i UK për Standardet Aktuariale;
- f) Nënkomiteti i Përfaqësuesve të Shtëpisë së Bardhë mbi Tregjet e Kapitalit, të Sigurimeve dhe Ndërmarrjet e Sponsorizuara nga Qeveria; dhe
- g) Grupi Këshillues për Krizën Financiare e Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Për më tepër, grupi i punës i SHNA (Shoqatës Ndërkombëtare Aktuariale) mbi Riskun e Krizës, ka monitoruar zhvillimet e shpejta politike dhe rregullative në nivel ndërkombëtar në përgjigje të KFG. Këto filluan me deklaratën e G20, menjëherë pas takimit të tij në 15 nëntor 2008, për të marrë masa për të forcuar transparencën dhe besimin në institucionet financiare, rritjen e kuadrit rregullativ të shëndoshë, rritjen e integritetit në tregjet financiare, forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe reformimin e institucioneve financiare ndërkombëtare të ndryshme. Që atëherë, ne kemi parë disa zhvillime të rëndësishme të cilat përfshijnë:

- a) Zhvillimin e vazhdueshëm të

koncepteve të miratuara nga G20, nga katër grupe pune kryesore, të cilat u ndoqën nga takimi i liderëve të G20 në Londër në prill;

- b) Prezantimin e administratës së re amerikane nga Presidenti Obama duke paraqitur një politikë fiskale stimuluese, si përqsje ndaj krizës, në një nivel i cili është i kundërshtueshëm në Evropë;
- c) Njoftime të rëndësishme nga organizma ndërkombëtarë të ndryshëm duke përfshirë Fondin Ndërkombëtar Monetar, Bankën për Marrëveshje Ndërkombëtare (BIS) dhe Bordin Financiar për Stabilitet;
- d) Njoftimin mbi paketa të mëdha për mbështetje financiare për bankat, të cilat varionin nga garancitë qeveritare në injeksione kapitali dhe shtetëzime të plota, të cilat zvogëluan dallimin, në disa raste, midis riskut të kreditimit të bankave dhe atij të Qeverisë;
- e) Shtrirja e plotë e kostos së dalë nga kriza tek Qeveria Amerikane, për parandalimin e falimentimit të AIG dhe zbulimi i vazhdimit të pagesës së bonuseve për drejtuesit e AIG dhe entiteteve të tjera, të cilat përfituan mbështetjen e Qeverisë;
- f) Negociata të vazhdueshme të cilat ndikuan në progresin dhe formën që do të ketë paketa reformuese rregullative e Solvency II për sigurimet në Evropë;
- g) Publikimi i Raportit të Grupit të 30-ve i kryesuar nga Paul Volcker në janar 2009;
- h) Publikimi i Raportit De Larosiere në shkurt 2009 për KE;
- i) Publikimi i Rishikimit të Turner-it në mars 2009 në UK.

Pjesa më e madhe e gjithë kësaj pune njeh tashmë rëndësinë e investigimit të prezantimit të masave rregullative dinamike kundër ciklike sesa ato pro ciklike, në të cilat rregullatorët do të ndryshonin në mënyrë transparente kërkesat për kapital për pjesëmarrësit e tregut (jo vetëm normat e interesit) kur paralajmërimet paraprake duken si shfaqje të “fluskave” të tregut. Kjo do t'i lejonte “amortizuesve të goditjeve” të kapitalit të jenë në vendin e duhur për të ulur fluskat e tregut përpara se ato të pëlcastin në mënyrë të dhimbshme dhe të krijojnë kapacitetin të lejojnë rënie të këtij kapitali gjatë periudhave të presionit të tregut, sesa nevoja për të vendosur kërkesa më të ashpra për kapital në kohë të tilla.

Gjithsesi, zbatimi i një koncepti të tillë kërkon një rikonsiderim themelor të asaj se si rregullimi i institucioneve financiare duhet të ndërveprojë me zbatimin e politikës monetare dhe fiskale dhe si rrjedhim sjell shumë çështje për qeveritë, rregullatorët dhe pjesëmarrësit në një treg financiar anembanë botës. Si rezultat, domosdoshmëria për të krijuar një “super rregullator” ose “krye mbikëqyrës të riskut” në çdo vend dhe se si ai do të funksionojë, është duke u diskutuar shumë dhe nxitur gjithashtu nga personalitete me influencë duke përfshirë Ben Bernanke, Kryetar i Rezervës Federale të SHBA. Përsëri, kjo është e ngjashme me përjasjen e mbrojtur në studimin e muajit shkurt të SHNA.

SHNA mbrojti këtë rol, për të administruar kërkesat e propozuara dinamike kundër ciklike për kapital dhe të lehtësojë një koordinim dhe bashkëpunim më të madh ndërmjet juridiksioneve kombëtare. Ai mund të krijohet si pjesë e bankës qendrore të çdo vendi. SHNA thekson që funksionet e këtij roli do të përfshijnë:

- a) Zhvillimin e një politike të “oreksit” për risk për treguesit kryesorë të riskut në nivel tregu;
- b) Monitorimin, menaxhimin dhe raportimin publik mbi treguesit e

riskut brenda “oreksit” për risk;

- c) Ndryshimin e kërkesave për kapital për pjesëmarrësit në tregjet e rregulluara sipas zgjedhjes së tij dhe;
- d) Lehtësimin e identifikimit të riskut dhe komunikimin me vendim marrës të përshtatshëm, në të dyja nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare.


Krijimi i një rrjeti ku role të tilla do të sigurojnë gjithashtu një kuadër për një menaxhim sa më të mirë të risqeve dhe të tejkalojnë barrierat gjeografike dhe industriale, të cilat sjellin mospërputhshmëri dhe boshllëqe e në mënyrë kritike dobësojnë protokollet aktuale të menaxhimit të riskut.

Tabela më poshtë tregon një arsye pse një kuadër i tillë është i nevojshëm duke ilustruar paaftësinë relative në uljet e normës zyrtare të interesit në SHBA gjatë krizës, të drejtuara nga një politikë tradicionale monetare në stimulimin e ekonomisë amerikane. Tabela 2 tregon progresin e të ardhurave nga bonot e klasifikuara me gradë investimi të SHBA gjatë kësaj periudhe. Për shkak se KFG shkaktoi një rritje thelbësore në shtrirjen e riskut të kreditit edhe huamarrësit me gradë investimi janë përballur më kosto më të larta totale të huamarrjes gjatë krizës, krahasuar me kostot më të ulëta të përgjithshme të huamarrjes, e kundërta e efektit nga uljet zyrtare në normat e interesit. Më tej, uljet zyrtare në normat të interesit të SHBA arritën nivele afër zeros, kështu që është e nevojshme që politika tradicionale monetare të plotësohet me “lehtësira sasiore” dhe masa të politikës fiskale.

Për këtë, koncepti i vendosjes së kërkesave dinamike për kapital (në përputhje me Studimin e SHNA në shkurt) do t'i jepte bankave qendrore dhe rregullatorëve mekanizma të tjerë për të



Table - USD Liquid Investment Grade Bonds



menaxhuar ekonominë në zgjerim në të ardhmen më shumë se sa të bazohen vetëm në politikat tradicionale monetare dhe atë fiskale. Më tepër, ndryshimet dinamike në kërkesat për kapital mund, nëse kërkohet, të targëtohen nga koha në kohë në tregje specifike “të tejzhvilluara” se sa aplikimi i instrumenteve relativisht të vonuar të politikës së normës së interesit në ekonomi.

Mbështetje e mëtejshme, për t’i dhënë rregullatorëve zgjedhje lidhur me këtë, rezultoi me një marrëveshje informale e realizuar në 26 mars 2009, lidhur me zhvillimin në vazhdim të kuadrit Solvency II të BE për siguruesit në të cilën janë marrë masa në mënyrë që të tentojnë dhe parandalojnë reagime negative ndërmjet rënieve të tregut dhe kërkesave për kapital. Në veçanti:

- Testi i qëndrueshmërisë së kapitalit mund të rritet ose reduktohet me 10% duke u varur nga lëvizjet në indeksin e përshtatshëm të kapitalit.
- Vendet anëtare kanë opsionin për të lejuar një test të qëndrueshmërisë së kapitalit me bazë jetëgjatësinë për bizneset e pensioneve, që përdorin transferime jashtë aseteve, me qëllim mospërfshirjen e tyre në vlerën neto të investitorëve (eng. ring – fenced)
- Në rastin e një rënieje të jashtëzakonshme në tregjet financiare, autoritetet mbikëqyrëse kanë opsionin për të zgjeruar periudhën gjatë të cilës mbulimi i Kërkesës për Mjaftueshmërinë e Kapitalit (SCR) duhet të rivendoset, në raste pamjaftueshmërie.

- Mbikëqyrësit gjithashtu do të kenë pushtetin të ndryshojnë parametrat e formulës standarde të SCR për një sigurues nëse ato besojnë që standardi SCR nuk reflekton profilin e riskut të atij entiteti.

Tema të tjera të dala, si nga raportet të cilave ju jemi referuar më sipër dhe në përputhje me udhëzimet e vendosura nga takimi i G20 në Londër në 2 prill, përfshijnë:

- a) Domosdoshmërinë për të mbyllur boshllëqet rregullative dhe të pasurit e një rregullimi, i cili të jetë më shumë i koordinuar në nivel ndërkombëtar, i bazuar në parime, i ndjeshëm ndaj riskut dhe më pak i nxitur nga industria (bankare, sigurimeve, fondeve të pensioneve, etj.) dhe vendosja gjeografike, me një mbikëqyrje efektive dhe të integruar të grupeve më të mëdha financiare ndërkombëtare, ndërsa kjo është e vështirë politikisht, është e qartë që ka një nevojë për të mbikëqyruar kompanitë holding të grupeve ndërkombëtare të shërbimeve financiare në një mënyrë të ngjashme me grupet e tjera;
- b) Paraqitjen e parimeve të cilat do të rritin kërkesat për kapital për çdo pjesëmarrës në treg, me incentiva për pagesat të cilat do të fokusohen më tepër në rezultatet në afate të shkurtra, në mënyrë që ato struktura pagesash dhe struktura të tjera incentivash të mos shtrembërojnë vlerësimin e duhur të riskut;
- c) Rregullimin e aktiviteteve të “bankingut hije” bazuar mbi substancën ekonomike sesa formën ligjore, kështu që disa prej fondeve mbrojtës eng. “hedge”, kompanive garantuese dhe siguruesve kanë të ngjarë të përballen me një rritje të raportimit dhe kërkesave për kapital minimal;
- d) Rregullat në rritje për agjencitë e klasifikimit të kreditit për të limituar konfliktet e interesit dhe përdorimin e metodologjive të papërshtatshme;
- e) Reformimin e standardeve të kontabilitetit, veçanërisht në lidhje me aktivitetet “e jashtë bilancit”, kontabilizimin e provigjoneve për humbjet nga huatë për bankat dhe opsioneve të ndryshme të disponueshme për transaksionet raportuese duke përfshirë instrumentat financiare;
- f) Reformimin e tregjeve të derivativave, kështu që çdo gjë që tregtohet “në tregjet mbi banak” do të përballlet me rregulla, dhe ato të tregtuara nëpërmjet një shkëmbimi, do të kenë kontrata të standardizuara të përcaktuara nga një entitet qëndror me opsione të hapura, të cilat janë subjekt i thirrjeve në llogaritë me pjesëmarrje, në mënyrë që të kontrollohet risku i palës tjetër (që të evitohet një përsëritje e ekspozimit të përqëndruar që kompanitë si AIG krijuan në këto tregje);
- g) Menaxhimin e riskut, i cili duhet të shikohet si i pavarur nga, dhe integral në funksionimin e biznesit të shërbimeve financiare, në mënyrë që ekipi i riskut të ketë lirinë dhe aftësinë e të pasurit një pikëpamje objektive, e cila mund të ndryshojë nga menaxhimi bazë në aksesin e plotë dhe të pakufizuar për të njëjtin informacion dhe pikëpamje të ndryshme në çështje materiale, të cilat duhet t’i raportohen bordit, dhe të jenë transparentë me rregullatorin;
- h) Rregjimin e Basel II, i cili udhëheq kërkesat për kapital minimal për bankat në nivel ndërkombëtar, duhet të rishikohet për të forcuar kërkesat për kapital, të kufizojë aktivitetet “e jashtë bilancit” dhe të reduktojë efektet pro ciklike; dhe
- i) Testet e qëndrueshmërisë dhe analizat e skenareve, duke përfshirë një vlerësim të ngjarjeve të cilat mund të jenë shumë ekstreme për të shkatërruar një kompani, duhet të formojnë një pjesë integrale

të proceseve të menaxhimit të riskut të një kompanie dhe të jenë si pjesë e vendimmarrjes normale të menaxhimit të lartë.

Një çështje tjetër me interes për aktuarët në këshillimin e fondeve të pensioneve, është kur aktuarë të caktuar duhet të emërohen nga sponsorët e planit dhe pjesëmarrësit e planit në mënyrë që të shmangen konfliktet e interesit, të cilat mund të dalin ndërmjet sponsorave të planit që mund të dëshirojnë të adoptojnë një vullnet më të madh për risk dhe ekspozim të investimeve tek kapitali për të reduktuar koston, kundrejt pjesëmarrësve të planit që mund të dëshirojnë për të adoptuar një risk më të ulët dhe ekspozim kapitali më të ulët, veçanërisht kur vendet e punës së pjesëmarrësve të planit janë në risk, nëse punëdhënësit e tyre përballen me presione financiare. Kjo mund të përfshijë një nevojë për testime skenaresh/stokastike të detyrueshme në raportet e financimit të politikave për planet e pensioneve për të siguruar që nivelet e riskut janë në përputhje me “oreksin” e targetuar për risk.

Në një afat më të gjatë, KGF gjithashtu rihap pyetjen nëse kthimi progresiv i skemave me përfitime të përcaktuara në marrëveshje të kursimeve dhe pensioneve më kontribut të përcaktuar në vitet e fundit, ka kontribuar në rritjen e riskut sistematik, duke transferuar risqe tek individët dhe duke hequr burimin e disa amortizatorëve në sistem. KFG gjithashtu paraqet një sfidë sektorit privat bazuar në industrinë e kursimeve kontraktuale (duke përfshirë pensionet dhe sigurimin e jetës) për t'i dhënë sigurinë klientëve të tyre kryesorë pa pasur burime të formave të ndryshme të mbështetjes qeveritare ose fuqinë taksuese të qeverive.

Konkluzion:

Ndikimet e KFG pa asnjë dyshim do të ndjehen për disa vite në vazhdim në mënyra të ndryshme. Aktuarët dhe klientët e tyre do të kenë nevojën të jenë në gadishmëri si ndaj risqeve dhe mundësive (duke përfshirë mundësitë për profesionin e aktuarit) që do të shfaqen si rezultat i KFG.

Edukimi i konsumatorit

IFRS dhe Solvency II: Ekspozimi dhe bashkëveprimi Global – Puna e IAIS.

(Pjesë e shkëputur nga: The Geneva Papers on Risk and Insurance Issues and practice, Vëllimi 33, nr. 1, janar 2009)

Parathënie

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS) është një organizatë ndërkombëtare, i cili përbëhet nga mbikëqyrës në sigurime nga 180 autoritete të 130 vendeve, që mbikëqyrin siguruesit të cilët përbëjnë përafërsisht 97% të tregjeve botërore të sigurimeve. Një nga objektivat e saj kryesore është të ndihmojë në zhvillimin e tregjeve të mirërregulluar të sigurimeve. Duke qenë se kjo kërkon një cilësi të lartë të raportimit financiar, IAIS është shumë i interesuar në zhvillimin e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar.

IAIS shikon me interes të veçantë projektet e Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Kontabilitetit (IASB), të cilat do të mund të influencojnë në modelin e përgjithshëm të kontabilitetit për shoqëritë e mbikëqyrura të sigurimeve me synimin e paraqitjes së një panorame kuptimplotë dhe ekonomikisht të fortë të këtyre shoqërive për tregjet e jashtme. Fokusi kryesor aktual për IAIS është Faza II e Projektit të IASB mbi Kontratat e Sigurimit, i cili do të konkludojë në një standard ndërkombëtar të

raportimit financiar për vlerësimin e detyrimeve në sigurime për qëllime të përgjithshme të raportimit financiar, dhe është i një interesi të veçantë për industrinë e sigurimeve dhe për mbikëqyrësit e sigurimeve.

Parimet kryesore të IAIS për raportimin financiar

IAIS mendon se do ishte më e preferueshme nëse metodologjitë për llogaritjen e njësive në publik, raportet financiare të të cilave mund të përdoren për, ose janë në përputhshmëri thelbësore me metodologjitë e përdorura për qëllime të raportimit tek rregullatori, të jenë me sa më pak ndryshime të mundshme për të përmbushur kërkesat e raportimit në mënyrë sa më të rregullt. Duke pasur këtë objektiv kryesor, IAIS është shumë aktiv në monitorimin e zhvillimeve tek IASB dhe në dhënien e kontributit në Bord. Ndonëse është dukshëm e preferueshme për modelin e matjes së kontratave të sigurimeve për raportim të rregullt për të qenë në përputhje me atë të përdorur për raportimin financiar për qëllime të përgjithshme, kjo nuk mund të jetë e mundur ose e përshtatshme për të gjitha rastet. Gjithsesi, IAIS beson që është e rëndësishme që janë të njohura ndryshimet ndërmjet kërkesave për raportim të rregullt dhe raportimit për qëllime të përgjithshme për publikun dhe që këto diferenca janë publikisht të shpjeguara. Në të kundërt, ka një risk të vënies në pikëpyetje nga konfuzioni publik të besueshmërisë të të dy regjimeve të raportimit.

Koordinimi i Punës së IAIS në Fazën II dhe Solvency

Në këndvështrimin e rëndësisë që ka puna e IASB mbi kontratat e sigurimit tek kompanitë e sigurimeve dhe mbikëqyrësit e tyre, 2 vjet më parë, IAIS krijoi një grup të ri pune, nënkomitetin e IAIS për Kontratat e Sigurimit, veçanërisht për të koordinuar pozicionin e IAIS dhe për të siguruar

të dhëna tek IASB lidhur me projektin e tij mbi kontratat e sigurimit dhe me projekte të tjera të rëndësishme.

Puna e këtij nënkomiteti është ngushtësisht e koordinuar me punën e IAIS në vlerësimin e aftësisë paguese. Në të njëjtën kohë, ndërsa IASB ka qenë shumë i angazhuar në Fazën II, IAIS gjithashtu ka punuar në një projekt ambicioz për të përcaktuar një kuadër ndërkombëtar për vlerësimin e aftësisë paguese. Në shkurt 2007, IAIS publikoi një studim, “*Struktura e përbashkët e IAIS për vlerësimin e aftësisë paguese të siguruesit*”. Ky studim pasoi një nga dy studimet e publikuara në vitin 2005 “*Një kuadër i ri për mbikëqyrësit në sigurime*”, e ndjekur nga “*Drejt një kuadri të përbashkët dhe standardeve të përbashkëta për vlerësimin e aftësisë paguese të siguruesve: Bazat për formulimin e kërkesave rregulluese financiare*”. Shumë nga çështjet dhe sfidat me të cilat përballet IASB në Fazën II, janë gjithashtu të identifikuar dhe të përfshira në këtë punim. IAIS operon në bashkëpunim të ngushtë me Shoqatën Ndërkombëtare Aktuariale (IAA) gjatë punimeve të tij mbi vlerësimin e aftësisë paguese. Lidhur me vlerësimin e detyrimeve të siguruesve, IAIS i kërkoi IAA për të dhëna formale për të asistuar në punën e tij në këtë fushë. Kjo rezultoi me nxjerrjen e një draft studimi nga IAA “*Llogaritja e detyrimeve për kontratat e sigurimeve: vlerësimi aktual dhe marzhet e riskut*”, që u qarkullua për konsultim në shkurt 2007. Puna e anëtarëve të IAA mbi këtë studim është zhvilluar në mënyrë paralele me punën më të fundit të IAIS mbi detyrimet në sigurime dhe anëtarët e IAA kanë marrë pjesë aktivisht në zhvillimet e punës së IAIS si në Fazën II dhe në vlerësimin e aftësisë paguese. IASB ka qenë shumë e interesuar në këtë projekt të IAA. Komisioni Evropian është i përfaqësuar në të dy nivelet e punës të IAIS të përmendura më sipër.



Për më tepër, disa juridiksione të përfaqësuara në nënkomitetet e IAIS të cilat punojnë mbi Fazën II dhe Aftësinë Pagueuse, janë të përfshira ngushtë në projektin, Aftësia Pagueuse II. Puna e IAIS në këto fusha është duke përparuar paralelisht me zhvillimet e Aftësisë Pagueuse II dhe nuk ka shkak për të besuar në këtë etapë që të ketë ndryshime të rëndësishme në filozofitë në themel të këtyre projekteve apo në përputhshmërinë e rezultateve të pritura.

Bazat e punës në Fazën II

Siç u përmend më sipër, IAIS ka një parim thelbësor që do të ishte më e preferueshme nëse metodat për llogaritjen e njësive në publik, raportet financiare të të cilave janë në gjendje të përdoren për, ose në përputhje me metodat të përdorura për qëllime të raportimit tek rregullatori, me sa më pak ndryshime të mundshme për të kënaqur kërkesat e një raportimi të rregullt. Në këtë këndvështrim puna e IAIS në Fazën II është të studiojë mundësitë për të përdorur Standardet ndërkombëtare për Raportimin Financiar (IFRS) një model i përshtatshëm si bazë për një mbikëqyrje të kujdesshme, duke marrë në konsideratë rezultatin e mundshëm të projektit të IASB, Faza II. Më qartë, mandati i Nënkomitetit të Kontratave të Sigurimit bën një pyetje “Çfarë metodologjish për përcaktimin e detyrimeve në sigurime, në përputhje me përfundimet e pritura nga puna në vazhdim e IASB, mund të jenë të pranueshme për të pasur mbikëqyrje të rregullt?”.

Në punën e tij për t'i siguruar të dhëna IASB, IAIS ka supozuar që përfundimi i pritshëm i Fazës II do të jetë modeli i *aktiveve/detyrimeve të ardhshme, model i rregulluar me vlerën në kohë të parasë dhe marzhet e riskut* (supozime të cilat qëndrojnë të vlefshme). Temat e adresuara nga IAIS në komentet e saj, bazuar në këto supozime,

zbulojnë karakteristikat e mundshme të një modeli të përshtatshëm e të qëndrueshëm, model rregullues dhe për qëllim të përgjithshëm për matjen e raporteve për rregullatorin për kontratat e sigurimit, si dhe cilat karakteristika nuk duhet të jenë në një model të tillë.

Punimi i parë dhe i dytë mbi detyrimet

Si rezultat të punës së saj, IAIS tashmë ka siguruar dy punime me komente për IASB si të dhëna për projektin Faza II. Punimi i parë mbi detyrimet u publikua në maj 2005 dhe u pasua një vit më vonë me punimin e dytë mbi detyrimet.

Punimi i dytë mbi detyrimet përcakton një numër parimesh, apo vrojtimesh kyçe, mbi temat e matjes, të cilat janë të përbashkëta për raportimin financiar për qëllime të përgjithshme dhe raportimin tek rregullatori të cilin IASB po e adreson në Fazën II.

Parimet e identifikuara përfshijnë disa veçori të matjes së detyrimeve në sigurime, marzhet e riskut dhe aspekte të kontabilizimit në sigurimin e jetës. Përveç parimit themelor, i përmendur më sipër, këto vëzhgime përfshijnë të tjera parime të rëndësishme:

- Flukset e ardhshme të parave të lidhura me marrëveshje të plotë me ankimuesin/përfituesin duhet të jenë bazat për matjen e detyrimeve të sigurimeve dhe kjo vlerë pritet të korrespondojë me vlerën e transferimit të detyrimit. Sipas kësaj përjasjeje, kontratat e sigurimeve duhet të maten si shuma e:
 - Një vlerësimi të paanshëm të flukseve të ardhshme të parasë që reflekton vlerën e kohës së parave: Vlerësim aktual (CE).
 - Një rregullimi për të reflektuar riskun: një marzh risku (metodat e llogaritjes të të cilit janë shqyrtuar nga IAA në bashkëpunim me IAIS).

- Pa marzheve shtesë siç është marzhi i fitimit.
- Një metodë që përdor të dhëna të vëzhguara nga tregje të thella (*deep markets*: tregje me një numër të madh pjesëmarrësish që kryejnë veprime pa ndikuar tek çmimi) dhe likuidë (*liquid markets*: tregje me një nivel të lartë të likuiditetit, shpesh që rezultojnë nga një numër i madh i blerësve dhe shitësve. (Eng: Market with a high degree of liquidity, often resulting from a large number of buyers and sellers. The opposite of thin market. Investorwords.com) në shtrirjen më të madhe të mundshme, është e përshtatshme në vlerësimin e detyrimeve në sigurime.
- Angazhime të ngjashme me profile risku të ngjashme duhet të rezultojnë në detyrime të ngjashme.
- Probabilitete që pasqyrojnë sjelljen e mundshme të policëmbajtësve janë të nevojshme për të arritur rezultate domethënëse.
- Përfshirja e rregullimeve për pozicionin e kreditit në matjen e detyrimeve të sigurimeve do të ishte çorientuese për përdoruesit e pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme.

(Të dyja punimet mbi detyrimet janë të disponueshme për publikun në faqen elektronike të IAIS www.iaisweb.org).

Një numër parimesh dhe vëzhgimesh kryesore në punim janë në përputhje të plotë me vendimet paraprake të Bordit në Fazën II. Ka parime të tjera për të cilat IAIS pozicionohet dakord me konkluzionet paraprake të Bordit, por me përpunim të mëtejshëm. Për shembull, IASB mbështet idenë e një modeli “dalje” për vlerësimin e detyrimeve të sigurimeve. Ky model lejon konceptin që fitimet mund të rrjedhin në fillim të

një kontrate (edhe pse IAIS nuk do të priste që kjo të ishte një ndodhi e zakonshme). IAIS mbështet këtë ide por do ta përpunonte duke lejuar njohjen e fitimeve të tilla vetëm në rastin kur një marzh i përshtatshëm dhe mjaftueshmërisht i besueshëm për pasigurinë (marzhi i riskut) është përdorur për matjen e detyrimeve.

Atëherë kur u publikua punimi i dytë mbi detyrimet, kishte dy pika ku IAIS pozicionohej jo dakord me konkluzionet paraprake të Bordit.

- *Kontratat e pjesëmarrjes*. Ndërkohë që këndvështrimi i IAIS është që bonuset opsionale duhet të llogariten si detyrime në bazë të flukseve të ardhshme të parave që priten, një konkluzion i tentuar i Bordit kishte qenë që një detyrim i pakushtëzuar, është kërkesa që shpërndarjet e ardhshme tek policëmbajtësit të kualifikohen si një detyrim. IAIS beson se një përjasje e tillë do të çonte drejt një keqpërfaqësimi të pozicionit financiar dhe paqëndrueshmëri të panevojshme, të dala kryesisht nga nevoja së pari për të rregjistruar shpërndarjet në të ardhmen të policëmbajtësve në kapital dhe më pas të transferohen këto tek detyrimet në momentin që ato bëhen detyrime të pakushtëzuara.

Gjithsesi, në fillim të këtij viti, Bordi e rishqyrtoi këtë çështje, duke përfunduar në një vendim tentativë të Bordit që zotimet konstruktive si dhe ligjore për të paguar dividendë policëmbajtësve do të çonin në një rritje të detyrimeve. Kjo e sjell pozicionin e IASB shumë më pranë atij të IAIS.

- *Pozicioni i kreditit*. IAIS beson se pozicionimi i kreditit të një siguruesi nuk është i rëndësishëm për, por mund të jetë çorientues në vlerësimin e detyrimeve të sigurimeve. Pavarësisht nga kundërshtimi i fortë nga disa anëtarë të tij, konkluzioni tentativ i Bordit është që pozicionimi i

kreditit duhet të përfshihet në metodën e vlerësimit. IAIS do konsiderojë të përpunojë para Bordit argumentat e tij kundër përdorimit të pozicionimit të kreditit në matjen e detyrimeve.

Ne vërejmë se IASB është gjithashtu duke konsideruar përfshirjen e një “marzhi shërbimi” në shtesë të vlerësimeve aktuale dhe marzhit të riskut dhe duket se është krijuar konfuzion rreth këtij koncepti që disa e interpretojnë si një “marxh fitimi” shtesë. Përpara se të merret një pozicion mbi këtë, ne do të parapëlqenim të lexonim më shumë nga Bordi mbi thelbin dhe praktikën e “marzhit të shërbimit”. Në fakt ky është një ilustrim i nevojës që IASB, të sigurojë udhëzime të qëndrueshëm mbi konceptet dhe parimet për vlerësimin e kontratave të sigurimit, me qëllim që të shmangen aplikime kontradiktore e të papërshtatshme të standardeve.

Reagimi ndaj punimit të dytë mbi detyrimet

Në vijim të publikimit të tij, Rob Esson, Kryetar i Nënkomitetit të Kontratave të Sigurimit, u ftua të bënte një prezantim mbi punimin e dytë mbi detyrimet Bordit gjatë një Seance Informimi në takimin e IASB në 22 qershor të vitit 2006 dhe më pas në takimin e grupit të punës për sigurimet të IASB në muajin pasardhës. Një çështje e rëndësishme e ngritur në këtë punim është që, nëse një detyrim i sigurimeve llogaritet bazuar në nocionin e transferimit, marrëveshja e fundit me ankimesin/përfituesin do të jetë një element kyç në një model të tillë. Ky mesazh në mënyrë të veçantë pati shumë mbështetje nga disa anëtarë të Bordit duke qenë se ai pajtohet me idenë e vlerësimit bazuar mbi transferimin e shlyerjeve të detyrimeve të siguruesit ndaj policëmbajtësit.

Punimi ka pasur një mbështetje të gjerë nga organizatat ndërkombëtare. Veçanërisht, CEIOPS ka dhënë një mbështetje publike për punimin me anë të një letre, në nëntor të vitit 2006, drejtuar Kryetarit të IASB nga Kryetari i asaj kohe Henrik Bjerre Nielsen. Studimi ka pasur gjithashtu një mbështetje nga industria e sigurimeve, dhe në të vërtetë kontributi, marrë nga mbikëqyrësit e industrisë në IAIS, ishte një pjesë e çmueshme e procesit.

Megjithatë, duhet theksuar se ka disa fusha të diskutueshme, siç janë shprehur disa organizata tregtare, p.sh. disa sektorë të industrisë kundërshtojnë skontimin (gjetja e vlerës së tashmë të një shume parash në një datë të caktuar në të ardhmen) të detyrimeve të sigurimit të jo-jetës.

Puna do të vazhdojë në të ardhmen

IAIS do të vazhdojë të japë kontribut për IASB gjatë gjithë Fazës II të projektit, nëpërmjet punës së Nënkomitetit të Kontratave të Sigurimit, si dhe nëpërmjet ripërfaqësimit në Grupin e Punës për Sigurimet të IASB. Faza e dytë për DP e IASB pritet të publikohet së shpejti dhe rishqyrtimi nga komentimi mbi DP dhe rezultatet që do vijjnë dhe diskutimi në IASB, do të vazhdojnë si punë me prioritet për IAIS, si gjatë muajve në vazhdim, po ashtu deri sa drejtimet dhe kërkesat për standardin e fazës së dytë të bëhen mjaftueshmërisht të qarta.

Ndërkohë, IAIS ka bërë komente mbi projektin e drejtuar paralelisht nga IASB mbi Matjen e Vlerës së Tregut (*Fair value*). Në nivelin që standardi që mund të dalë nga projekti për matjen e vlerës së tregut të jetë gjithashtu i mundshëm për t'u aplikuar në kontratat e sigurimit, është shumë e rëndësishme që të ketë komunikim të ngushtë

ndërmjet dy projekteve të IASB. Ne vërejmë që, në këtë projekt, Vlera e Tregut është përcaktuar si nocion transferimi (çmimi aktual i daljes). Megjithatë ne kemi disa komente për këtë përjasje kur bëhët fjalë për detyrimet, në veçanti ato që rezultojnë nga kontratat e sigurimit. Në momentin që nocioni i transferimit nuk merr në konsideratë marrëveshjen e finale, atëherë ne mund ta konsiderojmë këtë të papërshtatshme për aplikimin tek detyrimet në sigurime dhe ndoshta dhe për detyrimet e tjera.

Përgjithësisht, mbikëqyrësit e sigurimeve ashtu si dhe mbikëqyrësit e tjerë të kujdeshëm nuk mund të injorojnë zbatimin e kontabilitetit në stabilitetin e përgjithshëm të sistemit financiar. Pa kundërshtuar një model të tillë si Vlera e Tregut, gjithsecili nevojitet që të jetë i vetëdijshëm për vështirësinë e madhe për të siguruar besimin dhe “auditimin financiar” (dhe si rezultat të konsiderojë pasojat) të një aplikimi më të zgjeruar të modelit të Vlerës së Tregut. Ky, qartësisht, është rasti ku matja e Vlerës së Tregut është bazuar në të dhënat, të cilat nuk janë marrë direkt ose të frenuara haptazi nga një tregjet e thellë dhe likuid.

Puna e IAIS lidhur me vlerësimin e aftësisë paguese, gjithashtu do të vazhdojë të marrë në konsideratë zhvillimet në vendosjen e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar. Nëse pasqyrat financiare për qëllim të përgjithshëm (të rregulluara sipas nevojës) përbëjnë bazën për llogaritjen e aftësisë paguese për siguresit, në një mjedis të bazuar në parime, qëndrueshmëria në zbatimin dhe aplikimin e IFRS-ve do të jetë në çështje thelbësore. Ky do të ishte rasti për

IFRS-të që rezultojnë nga Faza II. Për shkak të kompleksitetit të përfshirë dhe faktit që është vështirë që standardi të jenë normativ,p.sh. është e vështirë të specifikosh një metodë të veçantë për llogaritjen e marzhit të riskut, do të paraqitet nevoja për një udhëzues aplikimi për lehtësimin e përputhshmërisë dhe konvergencës, si dhe për të mbështetur përdorimin e IFRS-ve si bazë për llogaritjen e aftësisë paguese. Ne këtë fushë, puna e përbashkët IAIS dhe IAA, në koordinim të ngushtë me IASB dhe IFRIC, është e rëndësishme në promovimin e një regjimi ku standardet, udhëzimet dhe interpretimet e kërkuara mund të jenë plotësuese me dhe të mbështesin objektivin e përgjithshëm të IAIS që një paketë e vetme e metodologjive mund të përdoret për llogaritjen e njësive si në raportet financiare për qëllime të përgjithshme dhe për raportet financiare për rregullatorët me sa më pak rregullime të mundshme ndërmjet të dyjave. Zhvillimi, zbatimi dhe aplikimi i IFRS, do të mbetet një ndër fushat kryesore për mbikëqyrësit e sigurimeve për të ardhmen e parashikueshme.

Për këtë numër punuan:

E. Shehi, R. Guri, R. Eltari, E. Zalta, O. Zaçaj,
E. Kokona